



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 25.02.2025

Nr: 10

Ora: 11:00

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 02, DATË 21.02.2025
TË DEPOZITUAR NGA KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRSIË**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 24.02.2025, me pjesëmarrjen e:

Iirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

OBJEKT: Kundërshtimin e pikës 1 të vendimit nr. 117, datë 19.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;

Konstatimin e pasaktësisë juridike të pikave 2 dhe 3 të vendimit nr. 117, datë 19.02.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe për rrjedhojë shfuqizimin e menjëhershëm të tyre.

BAZË LIGJORE: Nenet 21 pika 1 shkronja “b”, 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



VËREN:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 2 regj., datë 21.02.2025.

Në mbledhjen e datës 21.02.2025, pas relativitetit të z. Ilirjan Rusmali u konstatua se kërkesa ankimore nr.2, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 02, datë 21.02.2025, të paraqitur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 10.03.2025, ora 11:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	Lako	-	Anëtar
Elvis	Çefa	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar